



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.746/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci kryesues, Afijete Sada – Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e paraqitur nga Korab Zhugolli, nga Podujeva, Kandidat për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021, të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar korrigjimin e votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë.

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli Anr.746/2021 i datës 03.11.2021, i paraqitur nga Korab Zhugolli, nga Podujeva, Kandidat për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021, i datës 03.11.2021, për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.746/2021, të paraqitur nga Korab Zhugolli, Kandidat për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilin pretendon se i mungojnë votat e votuesve të cilët e kanë votuar në këto vendvotime 1812E/01R, 1812E/02R, 1812E/03R, 1812E/04D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga Korab Zhugolli nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Komunën e Podujevës, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar po nga i njëjti kandidat të paraqitur me datën 04.11.2021 është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton fakti se Apeli i parashtruar nga Korab Zhugolli nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Komunën e Podujevës, është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Anr.746/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevci



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.